

URDHËR
Nr. 2164, datë 21.11.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të germës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; germa “c”, e pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave znj. Jonida Brati, drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit Tekniko-Ligjor për sa vijon:

- Për të trajtuar dhe nënshkruar shkresat, me karakter njohës dhe informues, dalëse të Drejtorisë së Përgjithshme, pjesë e fushës së përgjegjësisë të Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit Tekniko-Ligjor, që u drejtohen të tretëve (personave fizikë, personave juridikë, publikë apo privatë), si dhe ato drejtuar strukturave të varësisë të ASHK-së në funksion të informimit të të tretëve.

Sa më sipër, bëjnë përjashtim shkresat që i drejtohen Presidentit të Republikës, Kuvendit, Kryeministrit, ministrave, sekretarit të përgjithshëm të Kryeministritë/ministrive, Avokatit të Popullit, gjykatave, prokurorive, prefektit, si dhe kryetarëve të bashkive, të cilat janë kompetencë e drejtorit të përgjithshëm dhe nënshkruhen prej tij.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit Tekniko-Ligjor, nëse e vlerëson të nevojshme, mund t'i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm shkresat të cilat përbëjnë një rëndësi të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”. Shkresat që trajtojnë problematika, mosmarrëveshje administrative apo civile që kërkojnë nxjerrjen e akteve administrative/kryerjen e veprimeve administrative nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm.

4. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit Tekniko-Ligjor, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, e Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohet duke filluar nga data e miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.

6. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Kontrollit Tekniko-Ligjor dhe drejtori i tyre, znj. Jonida Brati, dhe Drejtoria e Shërbimeve dhe Investimeve në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli